

---

## Konsultimi me publikun

---

### **ThimjoVoda PF**

Magazinin, rikuperim i  
hekurishteve/ skrapeve te metalit  
ose cmontim i mbetjeve nga  
motoret e makinave.

---

---

Shtator 2020

---

## 1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

### 1.1 Qellimi i projektit

Subjekti Thimjo Voda PF eshte e regjistruar ne organet tatimore me nr identifikimi NIPT K77428501O me seli ne Vlore, Delvine, Finiq, Vrion, Fshati Vrion ne Rrugen Nacionale. Thimjo Voda PF eshte e pajisur me lejen mjedisore Nr797 Prot, date 11.11.2019. Subjekti Thimjo Voda PF do shtoje aktivitetin per demontimin e makinave dhe do te filloje procedurat per leje mjedisote tipi B

### Klasifikimi bazuar ne ligjin 10448

Menaxhim i mbetjeve ID 5.8 Magazinim, rikuperim I hekurishteve/ skrapeve te metalit ose cmontim i mbetjeve nga motoret e makinave.

### 1.2 Objektivat e aktivitetit

Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Shkarkimet ne ujera nga procesi teknologjik
- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara nga procesi teknologjik
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones

Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

### 1.3 Vendodhja dhe karakteristikat fizike te projektit

Subjekti Thimjo Voda PF eshte i regjistruar ne organet tatimore me nr identifikimi NIPT K77428501O me seli ne Vlore, Delvine, Finiq, Vrion, Fshati Vrion ne Rrugen Nacionale. Distanca nga rruga nacionale eshte 1100 m larg. Thimjo Voda PF eshte e pajisur me lejen mjedisore Nr797 Prot, date 11.11.2019. Subjekti Thimjo Voda PF do shtoje aktivitetin per demontimin e makinave dhe do te filloje procedurat per leje mjedisote tipi B. Ky subjekt ka nje siperfaqe totale 300 m2 dhe siperfaqe ndertese 132.2 m2, Nr pasurie 399/1, Zone kadastrale 2324, Volum 4 faqe 100 .

## Koordinatat e subjektit:

Pika	X	Y
1	4423593.21	4408871.03
2	4423597.69	4408871.12
3	4423597.40	4408857.96
4	4423587.89	4408858.35
5	4423587.69	4408865.35
6	4423590.77	4408865.59
7	4423590.93	4408867.69
8	4423593.45	4408867.81



## 1.4 Procesi teknologjik

### Pershkrimi teknologjik

Demontimi i makinave nenkupton heqjen e te gjitha pjeseve te papedorshme qe ndodhen ne nje mjet motorrik, makine, fugon apo motorr dhe zevendesimi i tyre me pjese te reja Demontimi behet duke zbatuar te gjitha standartet.

Standarde quhen rregullat e perpiluara te cilat i perfshijne te gjitha te arriturat me të reja te teknikes qe percaktojne cilesine e prodhimit, materialit, permbajtjen, permasat, formen, masen, llojin, shenjat etj. Me ane te standardeve realizohet unifikimi, prodhimtaria më cilesore, lehtesohen kushtet e punes, kursimi i energjise, zvogelohen harxhimet për investime dhe çmimet e kushtimit.

Zhvillimi i industrisë dikton nevojën për një bashkëpunim me të madh ndërshtetëror në lëmin e teknikes, që mundësoi disa standarde shtetërore të afrohen njëri me tjetrin, dhe të formojnë standardin nderkombëtar.

### **Disa procese:**

Pasi makinat vijne në servis ato do likuidohen. Pas likuidimit makinat do ngrihen në vinca ose ndryshe urat ngritese.

Vincat kanë rendesi sepse ndërmjet tyre do bëhet ngritja peshe e automjeteve që vijne në këte servis dhe nepermjet tyre do bëhet kontroll i pjesëve xhenerike, montim dhe cmontim i pjesëve të lidhura me shasinë e motorrit.

Gjate cmontimit të makinave përdoren pajisje si trapano dore i cili cmonton nyjet lidhese të pjesëve të ndryshme të automjeteve. Trapano heq detalet, bulonat që mbajnë të qëndrueshme strukturën e çdo mjeti motorik

Gjithashtu dhe kacavidat ndihmojnë në cmontim të automjeteve.

Pasi cmontohen, bëhet nxjerrja e tyre, shkatërrohen, i presin.

Për sa i përket pjesëve të hequra, ato grumbullohen në një vend të caktuar në ambientet e subjektit (kryesisht në mjediset e jashtme të tij, dhe me pas lihen aty derisa të shiten, të ripërdoren ose në një trajtim të mëvonshëm të tyre.

Vajrat e makinave grumbullohen në fuci metalike të mbyllura. Për vajerat e makinave subjekti ka lidhur kontratë me shoqërinë Amos Oil përgjegjëse për grumbullim, transportim dhe trajtim të tyre.

### **Pajisje për cmontim janë**

vinca ose ura ngritese,  
trapano dore,  
kacavide.  
celesa

Gjate përzgjedhjes së materialit apo pjesës që do të demontohet duhet të merren parasysh këto kushte:

- kushtet eksploative (kushtet që paraqiten gjatë punës), duhet që pjesa e demontuar e mjetit motorik të mos jete në gjendje pune, pra të mos jete funksionale; për këte arsye do të hiqet.
- kushtet teknologjike, pjesa e demontuar të mos e kryejë funksionin e saj si pajisje e mjetit motorik.
- kushtet ekonomike; varet edhe sesa e kushtueshme është pjesa që do të demontohet nga makina.

### **Lendet e para të subjektit Thimjo Voda PF janë:**

makinat të aksidentuara që nuk rregullohen me

makina që nuk rregullohen me ose që rregullimi i tyre nuk sjell leverdi ekonomike, pra makinat në fund të ciklit të jetes së bashku me pjesët përberese.



Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë sjell vetëm ndikime positive sepse punëtorët e punësuar aty vijnë nga fshatrat përreth duke rritur kështu mirëqënien e tyre ekonomike. E gjithë zona nuk ka objekte të mbrojtura gjeologjike apo zona me interes gjeologjik. dhe gjithashtu nuk ben pjese ne ndonje zone te mbrojtur natyre .

#### **Sistemi i furnizimit me uje**

Furnizim i ujit behet me bote

#### **Rrjeti i kanalizimeve**

Nuk ka rrjet kanalizimesh. Ujerat e reshjeve perfundojne ne kanal kullues Dhe behet nje kontroll i vazhdueshem per ujerat e shiut qe derdhen ne keto kanale. Ndersa ujerat e zeza perfundojne ne gropen septike e ndertuar nga vete subjekti.

#### **Ndotja nga zhurmat**

Zhurmat ne kete subjekt vijne nga pajisjet e punes qe perdoren per cmontim ne subjekt dhe proceset e punes qe kryhen. Mbrojtja nga zhurma per zhvillimin e ketij aktiviteti duhet te sigurohet nga vet shoqeria, aktiviteti te ciles e gjeneron ate. Masat e mbrojtjes nga zhurma përbëjnë tërësinë e ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi.

Do behet kontrollin teknik per ecurine dhe mbarevajtjen sa me te mire te proceseve te punes.

Kujdes i vecante do te tregohet ne krijimin e kushteve te punes sa me konforte per punonjesin.

#### **Ndikime ne ajer**

Aktiviteti qe kryen ky subjekt nuk ka burim te ndotjes se ajrit pra nuk kemi shkarkime ne ajer. Per pluhurat qe krijohen gjate ngarkim ose shkarkim te lendeve te para nga subjekti duhet:

- lagje e ambjentit te punes si jashte dhe brenda me uje per shmangie pluhuri
- sistemim ambjenti.
- Ambjenti eshte i shtruar me cemento.
- mbjellje e pemeve me gjelberim te perhershem

#### **Te dhena nga mbetjet qe gjenerohen aty:**

Mbetjet jane kryesisht mbetje urbane te cilat largohen ne vendet e caktuara nga Pushteti Vendor. Per mbetjet e vajrave subjekti ka lidhur kontrate me shoqerine Amos Oil per grumbullimin, trasportimin dhe trajtim te vajrave te perdorur.

## 2 . IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

### 2.1 Metodologjia

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.

Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të veprimtarise, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh edhe lidhjet e tyre të ndërsjellta.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

Ky raport hartohet mbi bazen e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimi
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

- Mbrojtja e Perbersve të mjedisit klasifikohet në:
- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

Ndikimet kryesore ne mjedis nga funksionimi i ketij aktiviteti konsiston ne vija te pergjithshme si me poshte:

- Ndikim ne peizazhin e zones
- Emetimet ne ajer (gaze, grimca, aroma)
- Zhurmat dhe vibrimet
- Ndikime ne toke
- ndikime ne ujera siperfaqesore dhe nentokesore
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara dhe menaxhimi I tyre
- ndikime nderkufitare
- Rrjeti i energjise elektrike
- Rrjeti i furnizimit me uje
- Ndikime socio-ekonomike
- Siguria ne pune

Mjedisi i ndikuar	Ndikimi	masat zbutese qe duhet te ndermerren
Pejsazhi	Ndryshim i pejsazhit te zones	Mbjellje pemesh e bimesh ne perimetrin e te gjithë siperfaqes se subjektit per te permiresuar cilesine e ajrit ne zone.
Toke	Ndikim ne ndotje te tokes	Kontroll te vazhdueshem per pastertine Shtim i bimesise per te ndihmuar ne reduktim te ndotjes se tokes. Pastrim i gropes septike nga subjekte te licensuara.
Uje	Ndotje e ujerave siperfaqesore	Mirembajtje e kanalit kullues ku perfundojne ujerat e reshjeve.
	Ndotje e ujerave nentokesore	Kontroll te vazhdueshem per pastertin Kontroll i ujerave te shiut . Ujerat e shirave do perfundojne ne kanale kullues Kontroll dhe pastrim i vazhdueshem i gropes septike.
Ajer	Emisione gazesh.	Kontroll periodik i gjeneratorit . Monitorim i vazhdueshem gazeve dhe zhurmave por keto jane ne vlera te uleta pasi gjeneratori perdoret shume rralle, ne rast mungese energjie elektrike.
	Aromat	Te merren masa per minimizimin dhe/ose mbulimin e aromave te pakendshme ne mjedisin perreth . Aromat jane te paperfillshme. Instalim sistem aspirimi dhe kondicionim. Perdorim maskash nga punetoret per te mbrojtur shendetin.



	Zhurme, vibrime	Do behet kontrolli teknik per ecurine dhe mbarevajtjen sa me te mire te proceseve te punes gjate cmontimit.. Perdorim i rralle i gjeneratorit. Kujdes i vecante do te tregohet ne krijimin e kushteve te punes sa me konforte per punonjesin.
<b>Mjedisi biologjik</b>	Flora dhe fauna	Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i fabrikes, zone e varfer ne lloje bimore dhe zhtazore.
<b>Mbetjet</b>	Mbetje me karakter urban  Mbetje vajrash  Llumra nga gropa septike	Mbetjet urbane te perziera do depozitohen ne kosha te percaktuar nga pushteti vendor. Per mbetjet e vajrave subjekti ka lidhur kontrate me Amos Oil per grumbullim, transportim, trajtim te vajrave te perdorur.  Llumrat e gropes septike pastrohen nga kompani te licensuara
<b>Mjedisi human</b>	Shqetesim te banoreve te zones dhe subjekteve perreth	Te ndermerren masat e nevojshme per zhurmat, shkarkimet ne atmosfere dhe aromat. Marrje masash per oraret e punes, ne menyre qe banoret perreth te mos kene shqetesime.
	Ndikime nderkufitare	Ky aktivitet nuk ka ndikime me natyre nderkufitare sepse ndodhet brenda territorit te Bashkise Vlore dhe nuk ka kufinj tokësore me shtetet e tjera qe kufizojne Republikën e Shqipërisë
<b>Ndikime te tjera</b>	Konsumi i energjise	Energjia qe do te perdoret eshte energjia elektrike. Pas mbarimit te punes cdo pajisje do fiket per te pasur konsum energjie sa me te ulet.. Eshte instaluar dhe gjenerator te cilin e perdor vetem kur ikin dritat.
	Konsumi i ujit	Furnizim i ujit do behet me bote. .
	Siguria ne pune	Punonjesit para se te punesohen i nenshtrohen nje vizite mjekesore dhe me pas pajisen me nje libreze shendetesore e cila leshohet nga Drejtoria e Shendetit Publik. Cdo punonjes eshte njohes i mire i rregullave te sigurimit ne pune dhe njohes te mire te pajisjeve. Perdorim i uniformes, maskes, dorezave gjate orarit te punes. Pajisje me sistem zjarrfikes dhe kutine e ndihmes se shpejte. Kontroll teknik i pajisjeve te punes te cilat perdoren per demontim te automjeteve.



## MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

### Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore

Me qellim qe te parandalohen, shmangen, minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te projektit gjate zhvillimit te aktivitetit nga ana e subjektit Thimjo Voda PF duhet qe shoqeria te marre masat e nevojshme.

Lloji i masave per mbrojtjen e mjedisit ndahen ne:

1. teknike
2. organizative

#### Kuadri i masave teknike dhe organizative

Cfare	Si
<b>Parandalim</b>	<p>- Siperfaqet e subjektit jane te shtruara me cimento. Kontroll periodik i gjendjes teknike dhe mjeteve te transportit dhe pajisjeve te punes</p> <p>- Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per te garantuar nje produkt perfundimtar sipas kerkesave te klienteve dhe me kushte te larta higjieno-sanitare</p> <p>-Sigurimi i kontenitoreve qe do te perdoren per mbetjet deri ne kohen kur te transportohen ne kompanite ricikluese.</p>
	<p>-Pajisja e punonjesve me mjetet e pershtatshme mbrojtese si doreza, maska etj.</p> <p>-Vendosja e tabelave sinjalizuese ne raste emergjente te zjarrit, pikat e grumbullimit etj.</p>
<b>Kontroll</b>	<p>Sigurimi i te gjitha pajisjeve te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash.</p> <p>Lagje e sheshit te punes dhe rrugeve hyrese dhe dalese.</p> <p>Testim periodik i teknologjise se perdorur per cmontim automjetesh.</p> <p>Fikje e pajisjeve te punes pasi cdo proces te kete mbaruar.</p> <p>Kontroll i vazhdueshem i gropes septike. Monitorim i parametrave mjedisore per te reduktuar ndotjen nga ky subjekt. .</p>
<b>Nderhyrje</b>	<p>-Sigurimi i te gjitha pajisjeve te nevojshme per cmontim dhe nderhyrje ne rast emergjencash.</p> <p>- Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhjesh te pa parashikuara nga procesit teknologjik.</p> <p>- Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale</p> <p>- Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca)</p> <p>.Dezinfektimi i ambjenteve te punes</p>
<b>Administrim</b>	<p>- njohje sa me e mire e proceseve dhe pajisjeve qe do perdoren per cmontim.</p> <p>- Ndarje e pergjegjesise dhe adresim i sakte per ceshtje te sigurise</p> <p>Cdo punonjes te kete eksperience pune dhe te njohe mire rregullat e punes dhe mirembajtjes.</p>

#### Masat zbutese per mbrojtjen e mjedisit

Nr.	Ndikimi	Masat zbutese
1	Clirimi i aromash dhe gazesh gjate kryerjes se proceseve te punes	Kolaudimi i gjeneratorit dhe perdorim i lendeve djegese cilesore. Perdorim sa me i rralle i gjeneratorit. Pastrim ambjenti ne rast se ka derdhje aksidentale
2	Ndotje te ujrave siperfaqesore si pasoje e derdhjes se ujrave qe gjenerohen nga aktiviteti	Subjekti eshte njohes i mire i ligjit dhe ushtron aktivitetin e tij duke respektuar normat e percaktuara ne VKM 177 date 31.03.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritesa."Subjekti miremban kanalim kullues ku depozitohen ujerat e shesheve dhe ujerat atmosferike
3	Ndotja e tokes dhe ujrave nentokesore	Duhet realizuar shtrimi dhe sistemim i siperfaqeve te subjektit. . Ne raste aksidentesh te merren te gjitha masat per rikuperimin e ndotjes. mbjellje e bimesise ne zone
4	Manaxhimi i mbetjeve	Lidhja e kontratave me subjektet e licensuar me licensat e kategorise III.1.A/B dhe III.2.B nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave, per grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve ose nga vete subjekti. Per mbetjet urbane do behet depozitim i tyre ne kosha te percaktuar nga pushteti vendor, per mbetjet e vajrave subjekti ka lidhur kontrate me Amos Oil per grumbullimin, transportimin dhe trajtim te vajrave te perdorur.
5	Siguria e punonjesve	Subjekti duhet te marre masa per te vendosur nje sistem kunder zjarri ose isktintore ne pika te ndryshme te servisit Te vendosen sinjalistika e nevojshme te kryhet trajnimi perkates i punonjesve. Punonjesit te pajisen me uniforma pune dhe te gjitha mjetet mbrojtese si doreza dhe maska.
6	Rritja e trafikut te mjeteve te renda ne trafikun tokesor, por ne nivele te uleta	Shoqeria duhet te kete ne konsiderate: - te perdori infrastrukturen ekzistuese, - qarkullimi ne orare me trafik me pak te renduar, - reduktimi i renies se borive ne zona te banuara, - organizimi i hyrjes dhe daljes se mjeteve te renda nga servisi etj.
7	Zhurma nga veprimtaria	Procesi teknologjik nuk shoqerohet me nivele te larta te zhurmes.Venie e gjeneratorit ne pune vetem nese ka mungese se energjise elektrike. Ne pikat ku niveli i zhurmes eshte me i larte dhe koha

	e ekspozimit me e gjate te merren masa per punonjesit qe jane te ekspozuar duke perdorur mjete mbrojtese.
--	---

### Masat per mbrojtjen e ajrit nga makinerite e transportit

Nr.	Ndikimi	Masat zbutese
1	Pluhura dhe gaze te shkarkuara gjate fazes se dergimit te lendes se pare ne subjekt dhe gjate cmontimit te makinave	Rruget e brendshme duhet te jene te shtruara. Makinat qe vijne per cmontim do pastrohen per te eliminuar pluhurat Kolaudim gjeneratori. Perdorim sa me i rralle i tij lenda djegese te jete sa me cilesore.
2	Emetim zhurmash, vibracioni dhe aromash	Duhet te kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe ambjentet e punes per zhurmen e shkaktuar. Edhe per kete ndikim duhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorave te mjeteve; Kolaudim gjeneratori. Perdorim sa me i rralle i tij dhe lenda djegese te jete sa me cilesore

### Programi i monitorimit dhe elementet e tij

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te identifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (DRM, Bashki etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne DRM e Qarkut sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve.

Nr	Natyra e monitorimit	Frekuenca	Analiza
1	Monitorimi i shkarkimeve te gazta nga aktiviteti	Periodike (Cdo 6 muaj)	NOx, COx, SOx, H2S, O2
2	Monitorimi i zhurmes se shkaktuar	Periodik (raportim cdo 6 muaj)	Zhurma (dbA) nga aktiviteti i impiantit
3	Monitorim i lendes se ngurte pezull	Periodik (raportim cdo 6 muaj)	LNP mes, LNP max, PM10

\* Cdo parameter dhe ndikim qe mund te identifikohet nga aktiviteti mund te shtohet si parameter per tu monitoruar.